



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna e Kaçanikut**  
Opština Kacanik  
Municipal of Kacanik

01Nr. 104/02-8821/26  
Kaçanik, 30.04.2026

Në bazë të nenit 11 dhe 12. 1 dhe 2(d) lidhur me nenin 17 Ligjit Nr. 03L-040- Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28/4 Qershor 2008), të nenit 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087-Për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare Nr. 31/15 Qershor 2008) si dhe Ligjeve për ndryshim plotësimin e këtij ligji, Nr. 04/L- 111 të vitit 2012 dhe Ligjit Nr. 05/L -009 të vitit 2015, të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-8821/26 prej datës 16.04.2026, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 30 prill 2026, mori këtë:

### V E N D I M

#### PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR NPK “STACIONI I AUTOBUSAVE” SH. A – KAÇANIK

1. Me këtë Vendim, themelohet Komisioni Komunal i Aksionarëve, për Ndërmarrjen Publike Komunale “Stacioni i Autobusave” SH.A – Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi, do t'i ketë tre (3) anëtarë: 1 (një) anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe 2 (dy) anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi i Komunës.
2. Përbërja e komisionit komunale të aksionarëve, është si vijon:
  - 2.1 Arben Fera anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës,
  - 2.2 Brahim Imishti anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës,
  - 2.3 Arta Berisha Lika anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.
4. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.


**Me këtë Vendim do të njoftohen:** MAPL, Anëtarët e Komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë (përmes kësaj drejtorie njoftohet Ndërmarrja Publike Komunale “Stacioni i Autobusave” SH.A – Kaçanik dhe mekanizmat tjerë relevantë), Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Selajdin Troni



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Ekonomisë  
Ministarstvo Ekonomije/Ministry of Economy

Për:	Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut Erbllin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor MAPL
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në detyrë në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve/MAPL
Përmes:	Artane Rizvanolli, Ministre në detyrë e Ekonomisë  Leonita Shabani Mullarama, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë
Nga:	Deniza Krasniqi, Ud. Drejtore e Departamentit Ligjor/ME <span style="float: right;">Datë: 15.05.2026</span>
Zyrtarët përgjegjës: 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Dëfrim Pllashniku, Ud. Drejtor i NJPMNP-së  Arbërore Bërnica-Hasani, Analiste ligjore/NJPMNP
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr. 104/02-8821/26 i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut

I nderuar Kryetar z. Vishi,  
I nderuar Kryesues z. Troni,

Ministria e Ekonomisë ka pranuar kërkesën nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me Nr. prot. 854 datë 08.05.2026 për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit komunal të Komunës së Kaçanikut Vendimin 01 Nr.104/02-8821/26 për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Komunale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A Kaçanik, të miratuar më datë 30.04.2026 nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut.

Bazuar në nenin 9, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregullore (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave si dhe bazuar në legjislacionin përkatës për Ndërmarrje Publike, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë,

vlerëson se Vendimi 01 Nr.104/02-8821/26 për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Komunale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A Kaçanik, me kompetencë për të vepruar në emër të komunës përkatëse është në përputhje me nenin 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

### Arsyetim

Neni 5 paragrafi 5.2. i Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike përcakton se: *"Kur një komunë është aksionare në një Ndërmarrje Publike Lokale, të drejtat e saj të aksionarit ushtrohen nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar."*

Mbi këtë bazë, Vendimi i Komunës së Kaçanikut që përcakton përbërjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, me kompetencë për të vepruar në emër të komunës përkatëse, është në harmoni me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.

Ministria e Ekonomisë mbetet në dispozicion të Komunës dhe MAPL-së për çdo sqarim të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt,

*"Vlerësimi i dhënë nga Ministria e Ekonomisë përkatësi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin e Ministrisë së Ekonomisë si sponsorizuese e legjislacionit për Ndërmarrjet Publike"*